

RENIS HYKA
CADAVRE EXQUIS
PROZA SURREALISTE DHE ABSURDE

BOTIMET TOENA

Renis Hyka

Cadavre exquis

proza surrealiste dhe absurde

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2016

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Anrila Spahija

Korrektore letrare: Petrina Ago

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

Kopertina: Ana Shema

ISBN 978-9928-205-56-8

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi i materialeve që përmban ky libër me asnjë mjet apo formë, as me fotokopje, as pjesërisht, pa lejen me shkrim të Botimeve Toena.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Hyrje

Të them disa fjalë për të hedhur dritë mbi idenë e këtij libërthi, sepse pjesa tjetër le të jetë interpretim si ëndrrat. Ky botim i thjeshtë përcjell një eksperiment të vogël surrealist e psikik duke tentuar të shtyjë përtej këndvështrimit normal. Në këto 27 proza tregohen thjesht realitetet normale të para vetëm nga një kënd tjetër, jashtë të zakonshmes. Jo vetëm realitetet, por edhe ndjesitë kaotike e ankthi që janë prezent te njeriu, por që të burgosur në mendjen tonë, mbeten aty të harruar e për këtë arsye na

torturojnë vazhdimisht. Disa proza kanë temë vetëvrasjen duke e parë në këndvështrim ekzistencialist, si një lloj asgjësimi psikologjik, si zgjedhje komike. Është folur për fundin, sepse pa fund s'ka fillim të ri, për natën dhe errësirën si një oqean ku mendja noton pa limit, për monologun dhe përsiatjen ku mendja stakohet, për marrëzinë e histerinë si kolaps në marrëdhënien un-es. Dalí tha se surealizmi është destruktiv, por shkatërron atë çfarë është destinuar për të qenë e limituar. Pra, mendja e fantazia s'duhet të mjaftohen me realitetin. Ndërsa Andre Breton, mendja e vërtetë e surealizmit, tha se imagjinata është ajo që tenton të kthehet në realitet. Vërtet çdo prozë është një lloj “pazëlli”, që meriton të rilexohet për të gjetur enigmën. Nuk jam përpjekur aspak të shkruaj një libërth të mirë, por veç të një lloji tjetër e, për këtë arsye, i drejtohet sidomos atyre që nuk e

kanë zakon të lexojnë, sepse këtë do e kenë më të thjeshtë për një adaptim psikologjik jashtë serie. Meqenëse shumica e prozave janë shkruar nën hijen e natës, meritojnë natën për t'u lexuar, sepse do të jesh më i lirë për të dëgjuar thirrjen e pandërgjegjshme të librit, sikur *esi* i tërbuar të vërtitet në skutat e tunelet e mendjes duke kërkuar un-in për ta hequr qafe. Prozat janë të lidhura me njëra-tjetrën ashtu si “Cadavre exquis”, pra me pak kuptim, por mjaftueshëm për një lojë të këndshme prej së cilës ke çfarë të marrësh. Në qoftë se je i tillë, njeh Frojdin apo Dalin, librin do e rilexosh patjetër, por nëse s'do të kesh dëshirë për ta rilexuar edhe mund ta grisësh apo djegësh, sepse s'është e thënë të jetë për ty.

AUTORI

Pritja

Kisha ardhur më herët seç duhej. Pashë disa herë orën e dorës, që të sigurohesha për këtë, edhe pse e dija. Akrepat rrotulloheshin me hap të pazakontë; kështu dukej. Pandeha një çast se ata kishin ndalur, por ishte veç mendja ime që lëvizte ngadalë, duke dashur të ruante një kënaqësi të çuditshme pritjeje për çdo lëvizje akrepi. Binte shi. Çadra pikonte çepave. Sytë i mbaja hapur fort. Ajo mund të vinte ngado, mund të ishte kushdo nga hijet që vinin vërdallë. Njëra afrohet nga larg. Jo, nuk është ajo! As ajo hija pas asaj. Shihja

me radhë atë lukuni hijesh që krijoheshin me ndihmën e dritave të rrugës, të cilat nën këtë shi ngjanin si xixëllonja gjigante, por të lodhura. Më pëlqente kjo lojë hijesh. Çdo hije ishte në ato çaste një shpirt që gufonte kot shpirtin tim. Ndihesha Zoti i këtij teatri, më pas u ndjeva veç një spektator i mjerë, që vëzhgoja një pjesë të parëndësishme të botës. Ndërsa prisja, fantazova atë tek vinte, edhe pse nuk e kisha parë kurrë më parë, tek afrohej drejt meje me hap jo të sigurt, tek çapej me vështirësi e drojë, tek i jepte jetë kësaj copëz bote. Buzëqeshja e saj ndrinte errësirën. I zgjata dorën, por më parë kalova çadrën në të majtën. E tunda dorën në hapësirën boshe. Jo, ajo akoma s'kishte ardhur, por kjo s'më mërziti. U zgjova nga ky ëndërrim i shpejtë e fillova të kundroja me kënaqësi melankolike mimikat e njerëzve që kalonin pranë. Fytyrat e tyre ishin kaq të ndryshme, si në dukje ashtu

dhe në formë, ashtu si duhej për t'i kënaqur të gjithë. Mendova se duhet të kisha ardhur më herët për të gjetur në to fytyra të njohura. Nesër do të vija herët fare. Pashë orën. Kësaj radhe dridhesha pak, sepse e dija që orari i caktuar kishte kaluar e, ajo tashmë me siguri ishte më afër, ndoshta po më shihte nga larg. Ora kishte kaluar vetëm pak. Ngrita kokën, por ajo s'dukej akoma. Zemra rreh ndryshe kur kalon ora. Me kalimin e minutave do të shoh orën më shpesh e, do të psherëtitij për t'ia shtuar vetes ankthin. Por pritja nuk është dhe aq mizore, përndryshe askush s'do të priste. Shiu ishte monoton, disi edhe hapat e njerëzve, ashtu dhe koha ime, e cila ecte pa dëshirën time. Shihja njerëzit tek i hidhnin hapat me përtaci e zhdukeshin në asgjë, tek merrnin me vete kohën time e unë s'mund t'u shkoja pas për t'u kërkuar llogari. Unë rrija e prisja që kohët të zëvendësonin njëra-

tjetrën, ndërsa ajo me siguri ishte afër fare e njëra ndër ato kohë do ishte e saja. Edhe në qoftë se ajo do të vonohet unë do ta pres deri në përjetësi, sepse kam mësuar se përjetësia është diçka e bukur. Ja pra, pak dua që ajo të mos vijë kurrë se kështu ndoshta do të bëhem i përjetshëm. A nuk është kjo ajo çfarë kërkojnë të gjithë, përjetësia? Le të pres sot si dje, e çdo ditë më pas si sot. Ndoshta duke kaluar shekujt do të bëhem një statujë e fortë mermeri e kështu do të forcohet durimi im e sytë e mi plot pasion s'do të shteren në mijëvjeçarë duke parë udhën në pritje të saj. Por ajo do të vijë shpejt, s'do të më duhet të pres kaq gjatë, është pranë. “Mos jeni ju?”, iu drejtova dikujt. Ajo u tremb. Nuk ktheu përgjigje. Ndoshta nuk ishte ajo, por ndoshta ishte e u tremb nga unë, e iku për të mos u kthyer më. Ndoshta ishte ajo e s'më njohu! Mos ndoshta kam ndryshuar kaq

shumë? Mos kanë kaluar vite pritjeje? Ajo as që më njeh, por kjo ka kaq pak rëndësi. Çdo mundësi mund të quhet e mundshme. Them se ajo s'më njeh, por ndoshta unë kam shkelur shpesh nëpër ëndrrat e saj si një grabitës, që e ndjek në errësirë e, pasi e rrëmben, ia heq frikën duke i thënë: “Jam unë ai, që të priti e akoma të pret”. A thua këto fjalë do ta zbutin? Por ndoshta ajo nuk e ka parë kurrë këtë ëndërr, do të rrezikoj të mbetem veç grabitës. S'dua të riskoj. Më mirë le të vonohet dhe pak. Më vonë mund të dalin yjet e do të kem çfarë t'i tregoj, se pritja të bën fjalëpakë, se fjalët të bëhen shuk në grykë. Kaq shumë paskam për të thënë?! Jo, jo, në fakt s'kam asgjë e kam frikë të mbetem pa fjalë para saj, e të më pandehë memec, se kështu do të mendojë se s'do të mundesha kurrë t'i thosha fjalët që ajo do të dëgjojë, e do largohet pa thënë dhe ajo asgjë.

Shiu nuk po pushuaka sonte! Mos ndoshta ajo nuk vjen veç nga ky shi? Le të mallkoj shiun për të mos mallkuar atë. E mallkoj sa herë që shoh orën: “Shi i lig!”. E ora thotë se është vonë, mendoj se nuk do duket kurrë. Po ku i dihet! Pas pak shiu mund të pushojë e ajo vendos të vijë, në qoftë se akoma nuk është afër. Herë mendoj se ajo më sheh nga larg. Drita e dritares së atij apartamenti në katin e pestë, dhjetëra metra më larg, është e ndezur. Ndoshta ajo përgjon nga atje. Po pse e bën këtë vallë? Shpesh mendoj se ka frikë, frikë nga vetja, frikë nga unë, frikë nga frika. Ku i dihet! Por ndoshta do vetëm që të shohë vuajtjen e pritjes sime, e për këtë arsye nuk e ngrys asnjëherë fytyrën, e vazhdimisht qesh kot që ajo mos dallojë ankthin e padurimit tim. Ky dyshim do të më shtyjë që një ditë ndoshta ta lë atë për të pritur dikë tjetër, sepse ajo s’e meriton këtë pritje të gjatë. Por kot flas, sepse këtë

s'mund ta bëj, s'dua ta tradhtoj atë e, mbi të gjitha, s'dua ta tradhtoj pritjen. Seç dremita. U zgjova pak i trembur. Ëndërrova sikur ajo erdhi. Ma vuri dorën në sup për të më zgjuar pastaj u zhduk. Ishte aq e mirë, aq e mirë sa kjo më bëri të mendoj se ndoshta nuk ishte ajo. Ishte veç ëndërr, apo ndoshta erdhi vërtet? Kush mund ta dijë, ëndërr apo realitet, tashmë edhe netët kanë dritë. Ja, kaluan orë të tjera mes dremitjes e zgjimit dhe akoma s'po vjen. Shoh orën përherë e më shpesh dhe është tepër vonë, por një mendje më thotë se kurrë s'mund të jetë vonë për të edhe po nuk erdhi as sonte. Ndoshta do të vijë nesër ose pasnesër, ose ndoshta asnjëherë, si nuk erdhi netët e shkuara. E lashë çadrën aty ku kisha qëndruar, dëshmi të ardhjes sime, ndoshta ajo do të kalojë më vonë e do ta verë re atë, e do të ndihet në faj që është vonuar kaq shumë. Do të vij ta shoh nesër në qoftë se çadra ka

lëvizur, nëse ajo e ka marrë si dëshmi që ka kaluar këtej, apo si shenjë që kërkon falje. Ndoshta pranë çadrës sime do të lërë çadrën e saj si shoqëruese, për të më ftuar të vij sërish. Ku i dihet! Shiu binte edhe më fort. E lashë çadrën. Ika, u zhyta në shi.

Interpretimi i një makthi, interpretimi i realitetit

U zgjua nga një makth duke bërëtitur. Pa përreth i trembur. Merrte frymë me gulçe. Dhoma e tij ishte akoma e errët. Ndezi dritën. U ngrit avash. Hapi derën, doli në ballkon. Bënte ftohtë. Hipi në parvaz, kishte frikë, por u hodh. Filloi të binte me nxitim, por u zgjua duke ulëritur. Pa përreth si i tromaksur. Drita e dhomës ishte e ndezur. U ngrit dhe doli në ballkon me ngadalë. Pa poshtë në thellësinë boshe, mori frymë, pastaj u hodh. Rënia pasohej nga frika, e

cila rritej. U zgjua. Ishte djersitur i gjithi. Pa përreth me shqetësim. Dielli po lindte. U ngrit dhe u nis drejt ballkonit. Dera e saj ishte hapur. Pa poshtë, buzëqeshi lehtë, më pas u hodh. Por edhe kësaj here, para se ta prekte fundin, hapi sytë. U zgjua edhe më i trembur se më parë. Dielli kishte lindur. Fiku dritën e dhomës dhe u nis drejt ballkonit. Bënte më pak ftohtë. Kësaj radhe u mendua më gjatë, fundi nuk dukej, por e dinte se fundi ishte aty dhe donte ta cekte për t'u plandosur mbi të. U hodh duke menduar këtë gjë. Por në rënie u zgjua sërish. Ndiente panik. Me sytë hapur pa tavanin, i cili dukej i lartë, madje lartësohej ndërsa ai e shihte, e në të varej një portokall në vend të llambës. Zgjati dorën instinktivisht ta kapte, por ishte tepër lart, s'e arrinte dot. Kishte etje. Mbylli sytë. Rënia e mëparshme vazhdonte. I hapi sërish nga frika. Nuk rrinte dot shtrirë. I mbylli sytë sërish. Prapë rënia. I

hapi. U çua. Por u shtri prapë. Nuk rrinte dot as në këmbë. Nuk guxonte t'i mbyllte sytë më. Nuk dinte kush ishte më real: realiteti apo makthi?! Po më i frikshëm: makthi apo realiteti? S'dinte diferencën e tyre. Në faqen e murit varej portreti i saj me sytë drejt tij. Ajo e shihte me mëri. Ai ktheu sytë nga krahu tjetër. Nuk donte që ajo ta shihte. Dontë të ikte nga kjo dhomë e larg saj. U çua. Shkoi drejt portretit. E ktheu atë nga ana tjetër, tani ajo shihte murin. I ra përçark dhomës disa herë. Dridhej. Doli jashtë. Kishte frikë të hidhej. Kësaj radhe frika e mundi. U kthye në dhomë. Portreti ishte kthyer sërish dhe po e shikonte. E mori, doli jashtë në ballkon dhe e hodhi. Por kur u fut brenda portreti ra nga lart. Lart nuk ishte më tavani, shihte qiellin. E mori, e hodhi përsëri. Sapo u fut brenda sërish ra nga lart. S'dinte ç'të bënte, ajo ishte përherë aty, s'donte të ikte. Provoi edhe një

herë... njëlloj. Më pas u hodh vetë. U zgjua sërish. Pas zgjimit ajo sërish rrinte varur në mur. Në dhomë pa një derë, që nuk e kishte hasur më parë. U fut me nxitim. Dera kishte çelës, u mbyll brenda. Tani ishte vetëm. Kishte dhe një dritare të vogël sa për ta futur kokën. Nga aty hodhi çelësin. Pa jashtë, shihte detin. “Shpëtova”, tha. Qeshi me të madhe. Por ndaloi së qeshuri kur portreti i saj ndodhej sërish në atë dhomë të ngushtë. S’e dinte nga kishte ardhur, pas apo para tij, si një fantazmë apo mallkim. Mos ishte sëmundja e tij, apo damka e një plage të vjetër?! Provoi ta grisë. E pamundur. Provoi ta hedhë nga dritarja, por nuk e nxinte. Kishte ngelur aty, në atë dhomë të vogël, tepër të vogël për dy, ndoshta tepër të vogël edhe për një. Mbylli sytë, por kësaj radhe nuk pati kohë t’i hapte sërish.

Çështje politike

Të tre vazhdonim udhën për t'u ngjitur majë malit, mes pemëve gjysmë të zhveshura në gjysmerrësirën e natës, duke lënë pas hije të parregullta e të zbehta hëne. Vetëm ecnim të dy dhe ecjen e bënim me hap të kurdisur, marshi i tretë qëndronte pezull i mbërthyer nga krahët prej meje dhe shokut tim, që qëndronte në të majtë. Të vetmit dëshmitarë ishin bufat e natës, krejtësisht naivë e të padëmshëm, që as e kuptonin ç'krim po ndodhte. Kishim kohë që rrugën e bënim në një heshtje rituali, si duket të bindur se

krimet më të mëdha meritojnë qetësi. I treti qëndronte kokulur, ndoshta e pranonte fatin e tij.

- Kështu e ka jeta! - i thirra për t'i dhënë pak zemër, edhe pse s'më erdhi mirë që theva heshtjen. Shoku tjetër qeshi pa takt, aq sa bufat e përgjumur kthyen kokën të trembur nga fonia e të qeshurës së tij tejet qesharake. Pengu tha se kjo që ndodhi nuk ishte e jashtëzakonshme, se këtë ngjarje e priste prej kohësh. Zëri i tij s'më pëlqeu e ne qeshëm prapë, tanimë edhe me ironi për të shpërfillur fjalët që dëgjuam, sepse e dinin se gënjente, por pasi rikthyem seriozitetin ashtu siç e meritonte ngjarja, kuptova se isha pak kureshtar.

- Mos të ka shpëtuar ndonjë fjalë? - i thashë shokut tjetër, i cili u shfajësua shpejt duke u betuar se këtë s'do ta bënte kurrë. Nuk i besoja plotësisht, por s'kisha asnjë provë se

mund të gënjente. Pengu tundte kokën duke ngjallur kuriozitet meskin tek unë.

- Fol, - i thashë, - nga e dije!

Ndoshta bërtita më fort sesa duhej, doja t'i tregoja që e kisha në dorë.

- E dija sepse kështu ndodhi edhe ca vite më parë kur unë e ky shoku yt i sotëm të morëm ty në këto shtigje për të të hedhur në greminë! E prisja këtë hakmarrje e në çdo mbrëmje sapo binte nata bëhesha gati...

Ndali së foluri për një çast. Për dreq ai mbante mend traumën time! Kisha menduar se ajo histori qe harruar, që ishte mbuluar me pluhur nga koha, kishte mbetur veç në faqe të mykura gazetash, për më tepër atë histori e kujtoja aq të largët sa e pata bindur veten se nuk kishte ndodhur vërtet. Mendja ime iu kthye realitetit, e pashë ngultas pengun, por si dukej ky njeri dinak kishte ndaluar enkas një çast për t'u siguruar se po ndiqej me interes

ose ndoshta për të parë mimikën time të rënë ndërsa kujtoja atë histori. Bile guxoi të pyeste edhe nëse mundej ta vazhdonte rrëfimin dhe kulmi ishte se e vazhdoi pa marrë asnjë aprovim.

- Por mos më thuaj se nuk e mban mend këtë rrugë! - tha. - Atëherë ishte ti ai që qëndroje në vendin tim, unë në vendin e shokut tënd e shoku yt në vendin tënd!

I dhashë një të goditur që të ndalte. Mund ta kisha mbytur në vend, por ai nuk foli më. Shoku u mjaftua me një buzëqeshje naive dhe me fjalët se e shkuara harrohet. Fjalë fatale, por duhet të qëndroja i qetë dhe të pohoja duke gënjyer se e shkuara harrohet, por edhe bufat kishin kuptuar diçka ndryshe. Mund ta kisha mbytur dhe atë, por duhet ta duroja sepse ai më duhej. Rruga vazhdoi. Bëra sikur nuk kishte ndodhur asgjë. Tensioni si duket u fsheh nën natën pa ngjyrë. Mendova edhe

një herë për atë histori që kishte ndodhur vite më parë, kur më patën marrë zvarrë në këtë rrugë për të më flakur më pas në greminë. M'u deshën vite që ta merrja veten e të rikthehesha sërish. I hidhja majtas sytë te shoku që qëndronte fodull në dukje. Por e dija që s'ishte fodull dhe aq shok sa dukej. Në të vërtetë ndieja pështirosje për të, por më duhej. Gati arritëm aty ku duhet të arrinim. Por po habitesha pse ishte kaq i qetë pengu. Mos ndoshta është një lojë e këtyre të dyve e më kanë ngritur kurth? Edhe mundej, nga tipa si këta çfarë s'mund të presësh. Dyshimi po tendosej deri në këputje. Duhet të qëndroja sa më i qetë e vigjilent, por s'kisha aspak qetësi. Kur arritëm majë malit, u bëmë gati për t'i dhënë të shtyrën e fundit pengut. "Fjalën e fundit?", i thashë. "Do të rikthehem", tha ai që as nuk priti ta shtynim, por u hodh vetë. U pamë me shokun në sy si lojtarë shahu,

kuptohej që urreheshim edhe pse e quanim njëri-tjetrin “shok”, sepse kështu duhej. Ai s’tha asnjë fjalë, madje edhe gjatë kthimit s’foli fare. As unë s’bëra zë, thjesht vëzhgova mirë rrugën se me siguri pas disa vitesh kur ai që sapo u hodh të rikthehet do ta ribëjmë këtë udhë e me siguri po të tre bashkë, por nuk dihet se kush do të jetë viktima e asaj radhe.

Një kujtim në të pandërgjegjshmen

I burgosuri po shihte nga dritarja me dëshirën të dilte nga qelia e ta përqafonte realitetin, ndërsa dëgjonte rojën tek gërhiste në një gjumë në dukje të thellë. Shkoi drejt derës së qelisë, e cila nuk mbyllej asnjëherë me çelës, e lëvizi ngadalë, e hapi mjaftueshëm për të kaluar trupin, por, pa bërë hapin e parë jashtë, roja i dha një të shtyrë derës së hekurt dhe i dënuari u përplas sërish brenda në qeli.

- Të kotë e ke, - i tha, - sa të jem unë këtu s'do të dalësh kurrë!

I burgosuri e dinte këtë, ishte e njëmijta herë që kjo tentativë përfundonte kështu, por gjithmonë i thoshte vetes se një ditë do ta gjente një mënyrë për t'ia mbathur. Roja mendohej të ishte gjithmonë vigjilent, edhe kur ishte në gjumë, njërin sy e mbante hapur aq sa mjaftonte. Ndonjëherë ishte edhe i lodhur, por kurrë mjaftueshëm që i burgosuri të ikte. Rrinte pas asaj dere që nga koha kur i dënuari ndodhej brenda, dhe nuk e shihte kurrë gjatë në sy atë, nga frika se mos i vinte keq e tundohej ta linte të lirë. “Jam njerëzor, - i thoshte roja, - por kam një punë për të kryer”. I burgosuri kishte provuar ta mashtronte, kishte provuar hile të ndryshme, herë më dhunë, madje i ishte lutur, por s’kishin funksionuar.

- Nuk prekem lehtë, - thoshte roja e gjithmonë kthente kokën nga krahu tjetër, duke tentuar ta fshihte sa më mirë edhe

ankthin e tij, ankthin e kryerjes së punës për të cilën ekzistonte. I burgosuri çfarë nuk sajoi për të dalë, por kërkesave të tij roja u mësua t'i përgjigjej thatë e shkurt vetëm me "jo", sepse e dinte që i burgosuri i tij më kalimin e viteve do të bëhej përherë e më dinak e nuk donte të ngatërrohej në lojëra të rrezikshme fjalësh. Me shtimin e tentativave për arratisje, rritej edhe ankthi i rojës. Ai prej vitesh jetonte me këtë barrë. Puna nuk ishte fort e lehtë. Shpesh zgjohej natën plot frikë e shihte brenda qelisë se mos ndoshta kishte ikur. Ëndrrat e natës lidheshin vetëm me atë të burgosur. Frika ndonjëherë e kaplonte edhe ditën. Kishte raste që i burgosuri bëhej agresiv dhe kërkonte t'i shkulte hekurat e qelisë, bërtiste e bëhej i padurueshëm, por i duhej ta duronte e ta ruante atë pas derës që nuk kyçej kurrë. Në të vërtetë ia kishte frikën dhe nuk e shfaqte se përndryshe ishte i marrë

fund. Shpesh mendonte se do të ishte mirë të bënte enkas të hutuarin, që tjetri të dilte, e kështu të përfundonte njëherë e mirë edhe ankthi i tij. Por kishte frikë pasojat. Realisht nuk e dinte çfarë pasojash do të binin mbi të, e kësaj i frikësohej më tepër. Vitet kalonin. Qelia rrënohej kohë pas kohe.

- Së shpejti do të shembet ky burg. Më lër të dal sa jam në kohë!

- Jo.

Pas kaq kohësh roja dhe i burgosuri ishin kthyer në të burgosurit e njëri-tjetrit. Pa njërin nuk ishte e nevojshme as ekzistenca e tjetrit.

- Pse të kanë burgosur?

- Nuk e di, por ti duhet ta dish! Ti je roja im, ti më ruan dhe duhet ta dish pse po më ruan!

- Unë mbaj mend diçka turbullt, tani s'më kujtohet mirë. Kohë më parë ma kanë treguar, tashmë e kam harruar. Ti e di sa kohë ke i burgosur?